PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës:	**KSC-BC-2020-05**
	Prokurori kundër Salih Mustafës
Vendosi:	**Trupi Gjykues I**
	Gjykatëse Mapi Feld-Folia, kryegjykatëse
	Gjykatës Roland Dekers
	Gjykatës Zhilber Biti
	Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë
Administratore:	Fidelma Donlon
Data:	20 maj 2021
Gjuha:	Anglishte
Klasifikimi:	**Publik**

Vendim për caktimin e datave për mbajtjen e konferencave përgatitore për gjykimin dhe për parashtrime nga palët

---

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit
Julius von Bone

Mbrojtëses së viktimave
Ani Pues

PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

TRUPI GJYKUES I ("Trupi Gjykues")[1] merr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 15 shkurt 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi dosjen paraprake, listën e dëshmitarëve ("lista e dëshmitarëve të ZPS-së") dhe listën e provave materiale, në përputhje me rregullën 95(4) të Rregullores.[2]

2. Më 30 prill 2021, Mbrojtja dorëzoi dosjen paraprake, listën e dëshmitarëve ("lista e dëshmitarëve të Mbrojtjes") dhe listën e provave materiale ("lista e provave materiale të Mbrojtjes"), në përputhje me rregullën 95(5) të Rregullores.[3]

3. Më 30 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori "Vendimin e dytë mbi pjesëmarrjen e viktimave", me të cilin viktimat 05/05, 06/05, 07/05, 08/05, dhe 09/05 u pranuan të marrin pjesë në proces.[4]

4. Më 7 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi Trupit Gjykues dosjen e çështjes, në përputhje me rregullën 98 të Rregullores.[5]

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Paneli vë në dukje nenin 40(2) dhe (6) të Ligjit dhe rregullat 116-119 të Rregullores.

---

[1] KSC-BC-2020-05, F00114, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Trupit Gjykues I*, 5 maj 2021, publik.
[2] KSC-BC-2020-05, F00082/A01, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i dosjes paraprake me listën e dëshmitarëve dhe listën e provave materiale*, 15 shkurt 2021, publik, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i korrigjuar i dosjes paraprake u protokollua më 23 shkurt 2021, F00088/A01, si version konfidencial dhe version rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.
[3] KSC-BC-2020-05, F00106/COR, Mbrojtja, *Version i korrigjuar i Parashtrimit të dosjes paraprake, listës së dëshmitarëve dhe listës së provave materiale*, 30 prill 2021, publik, me shtojcat 1-3, konfidenciale.
[4] KSC-BC-2020-05, F00105, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim i dytë mbi pjesëmarrjen e viktimave*, 30 prill 2021, para. 54.
[5] KSC-BC-2020-05, F00119, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për kalimin e dosjes gjyqësore Trupit Gjykues I*, 7 maj 2021, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale, dhe shtojcën 2, konfidenciale.

PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

III. DISKUTIM

6. Në përputhje me nenet 21, 23, 34(8), 40(2) dhe (6) të Ligjit dhe rregullën 116(1), (3) dhe (4) të Rregullores, Trupi Gjykues mund të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përgatitjen dhe zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të gjykimit. Këto masa përfshijnë, mes tjerash: miratimin e procedurave, modaliteteve dhe udhëzimeve për zhvillimin e procesit gjyqësor; caktimin e afateve për palët dhe pjesëmarrësit për dorëzimin e mocioneve para fillimit të gjykimit; verifikimin e përmbushjes prej palëve të detyrimeve për nxjerrjen e materialit ; dhe sigurimin e masave mbrojtëse përkatëse për dëshmitarët dhe viktimat pjesëmarrëse në proces.

7. Trupi Gjykues gjithashtu vlerëson se, në përputhje me nenin 39 të Ligjit dhe rregullat 95 dhe 98 të Rregullores, është, para së gjithash, detyrë e Gjykatësit të Procedurës Paraprake që ta përgatisë çështjen për gjykim, ndër të tjera përmes caktimit të gjuhës së punës së procesit; vendimit mbi kornizën ligjore në lidhje me kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces dhe pranimin e tyre si viktima pjesëmarrëse; përcaktimit të sistemit dhe afateve për nxjerrjen e provave dhe redaktimin e materialit; autorizimit të masave mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat; dhe, në përgjithësi, miratimit të çfarëdo procedure tjetër për të siguruar që palët dhe dosja e çështjes gjyqësore të jenë të gatshme për gjykim. Prandaj, përveç nëse vendos ndryshe me nismën e vet ose me kërkesë të palëve apo pjesëmarrësve, Trupi Gjykues nuk ka ndërmend të bëjë modifikime ose të vendosë nga fillimi në lidhje me asnjë çështje për të cilën tashmë është marrë vendim nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Rrjedhimisht, vendimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake vazhdojnë të vlejnë para Trupit Gjykues.

8. Në përputhje me rregullat 116-119 të Rregullores dhe për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykim, Trupi Gjykues e konsideron të përshtatshme që konferencat përgatitore për gjykimin të mbahen të mërkurën, më 9 qershor 2021, në orën 09:30, të

PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

enjten, më 10 qershor 2021, dhe të premten, më 11 qershor 2021. Në këtë kontekst, Trupi Gjykues thekson se, megjithëse në Rregullore parashikohen konferenca përgatitore të ndryshme dhe të njëpasnjëshme (konferenca përgatitore për gjykimin në rregullën 117, konferenca përgatitore për Prokurorin e Specializuar në rregullën 118, dhe konferenca përgatitore për Mbrojtjen në rregullën 119), neni 40(2) i Ligjit i jep Trupit Gjykues kompetencë diskrecionale për të organizuar proces të drejtë dhe të shpejtë në mënyrën që e gjykon të arsyeshme. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues e gjykon të arsyeshme dhe efikase që të mblidhen - sipas mundësisë menjëherë - të gjitha parashtrimet që i duhen për nxjerrjen e udhëzimeve në lidhje me zhvillimin e procesit gjyqësor. Trupi Gjykues mund të vendosë të mbajë konferenca të mëtejshme për ecurinë e çështjes, qoftë me nismën e vet ose me kërkesë të palëve ose të mbrojtëses së viktimave. Trupi Gjykues do t'u kërkojë ZPS-së, Mbrojtjes, mbrojtëses së viktimave dhe Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) që të paraqesin parashtrime për një numër pikash, sipas renditjes dhe mënyrës së dhënë më poshtë:

A. HETIMET DHE NXJERRJA E PROVAVE

a. Konfirmim nga ZPS-ja se i ka përfunduar hetimet dhe nxjerrjen e provave fajësuese në këtë çështje;

b. Nëse ZPS-ja ka ndërmend t'i nxjerrë Mbrojtjes prova shfajësuese të tjera sipas rregullës 103 të Rregullores, apo material ose prova të tjera sipas rregullës 102(3) të Rregullores dhe, nëse po, sa dhe kur; gjithashtu, nëse ZPS-ja synon të kërkojë redaktimin e këtij materiali dhe, nëse po, kur;

c. Nëse në këtë fazë Mbrojtja parashikon të zhvillojë hetime të mëtutjeshme dhe sa kohë afërsisht do t'i duhet për t'i përfunduar ato hetime;

PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

d. Nëse në këtë fazë, si rezultat i atyre hetimeve, Mbrojtja parashikon të nxjerrë prova shtesë dhe të ndryshojë dosjen paraprake, dhe/ose listën e dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe/ose listën e provave materiale të Mbrojtjes; dhe

e. Nëse Mbrojtja do të kërkojë mbajtjen e një seance të mbyllur *ex parte* në të ardhmen e afërt për ta përditësuar Trupi Gjykues në lidhje me çfarëdo çështje që ka të bëjë me përgatitjet e saj për gjykim, përfshirë qasjen në mjetet e nevojshme për të ndihmuar z. Mustafa.

B. VIZITA NË VENDIN E KRIMIT

a. Parashtrime nga palët dhe mbrojtësja e viktimave në lidhje me domosdoshmërinë e administrimit të duhur të drejtësisë dhe caktimin e kohës për të vizituar vendin e krimit, në përputhje me rregullën 74 të Rregullores.

C. ZHVILLIMI I PROCEDURAVE

1. Fillimi i gjykimit dhe deklaratat hyrëse

9. Trupi Gjykues synon që deklaratat hyrëse të bëhen tërësisht në seancë publike dhe kërkon nga palët dhe mbrojtësja e viktimave që të përgatiten duke mbajtur këtë parasysh.

a. Parashtrime nga palët dhe mbrojtësja e viktimave në lidhje me datën paraprake për fillimin e gjykimit, nëse është e mundshme para pushimit veror të gjykatës;

b. Nëse ZPS-ja ka ndërmend të bëjë deklaratë hyrëse në përputhje me rregullën 126(1) të Rregullores dhe, nëse po: (i) sa kohë do t'i duhet; dhe (ii) a do të përdorë materiale vizuale ndihmëse apo materiale të tjera;

PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

c. Nëse mbrojtësja e viktimave ka ndërmend të bëjë deklaratë hyrëse në përputhje me rregullën 126(3) të Rregullores dhe, nëse po: (i) sa kohë do t'i duhet; dhe (ii) a do të përdorë materiale vizuale ndihmëse apo materiale të tjera;

d. Nëse në këtë fazë Mbrojtja parashikon të bëjë deklaratë hyrëse në përputhje me rregullën 126(2) të Rregullores dhe, nëse po: (i) a do ta bëjë deklaratën hyrëse menjëherë pas deklaratave hyrëse të ZPS-së dhe Mbrojtëses së Viktimave, nëse do të ketë, apo para fillimit të paraqitjes së provave të veta; (ii) sa kohë do t'i duhet; dhe (iii) a do të përdorë materiale vizuale ndihmëse apo materiale të tjera; dhe

e. Nëse në këtë fazë Mbrojtja mund të bëjë të ditur nëse z. Mustafa dëshiron të bëjë deklaratë pa betim në përputhje me rregullën 142(1) të Rregullores dhe, nëse po, a do ta bëjë atë së bashku me deklaratën hyrëse të Mbrojtjes apo në një fazë të mëvonshme të gjykimit.

2. Procesi i informimit të dëshmitarëve para dhënies së dëshmisë

10. Parashtrime nga palët, mbrojtësja e viktimave dhe ZMMD-ja, ndër të tjera në lidhje me:

a. procesin e informimit të dëshmitarëve para dhënies së dëshmive të tyre përkatëse, veçanërisht datën e ndërprerjes së kontaktit midis subjektit thirrës dhe dëshmitarit para dhënies së dëshmisë; ndihmën e ZMMD-së në lehtësimin e komunikimit me subjektin thirrës gjatë procesit të informimit; shkallën e komunikimit midis subjektit thirrës dhe dëshmitarit; dhe përfshirjen e mbrojtëses së viktimave që përfaqëson dëshmitarët me status të dyfishtë;

b. informimin e ZMMD-së nga subjekti thirrës në lidhje me dëshmitarët që do të paraqiten;

PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

c. takimin e kortezisë midis palëve dhe mbrojtëses së viktimave;

d. njohjen me sallën e gjyqit;

e. rileximin e deklaratave të mëparshme dhe afatet për dhënien e materialit ZMMD-së nga subjekti thirrës;

f. ndihmën e ZMMD-së gjatë procesit të informimit të dëshmitarëve, përfshirë gjatë rileximit të deklaratave të mëparshme;

g. informimin e dëshmitarëve në lidhje me masat mbrojtëse në fuqi;

h. rrezikun e vetëfajësimit dhe këshillimin juridik; dhe

i. ndihmën për dëshmitarët në gjykatë, përfshirë ndihmën mjekësore dhe psikologjike dhe çdo përkrahje përkatëse ose masa të tjera të veçanta.

3. Dëshmitarët-viktimat me status të dyfishtë

Parashtrime nga ZPS-ja dhe mbrojtësja e viktimave në lidhje me atë nëse kanë shkëmbyer informacion relevant për të identifikuar se cilat viktima pjesëmarrëse janë njëkohësisht edhe dëshmitarë të ZPS-së dhe anasjelltas, dhe, po qe se jo, nëse planifikojnë ta bëjnë këtë, ose ndryshe, nëse kanë vërejtje në lidhje me një komunikim ose nxjerrje të tillë informacioni, përfshirë ZMMD-së.

4. Paraqitja e dëshmive (të dëshmitarëve) nga palët dhe pjesëmarrësit

a. Konfirmim[6] nga ZPS-ja i numrit të dëshmitarëve që synon të thërrasë, sa kohë kërkon për marrjen në pyetje të tyre, dhe a ka ndërmend të thërrasë dëshmitarë ekspertë;

[6] Shih Listën e dëshmitarëve të ZPS-së, f. 1-2.

PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

b. Nëse ZPS-ja ka ndërmend të kërkojë pranimin e deklaratave apo transkripteve të dëshmive të mëparshme në vend të dëshmive gojore sipas rregullave 153-155 të Rregullores dhe, nëse po, në lidhje me cilët dëshmitarë, sa prova materiale dhe sipas cilës dispozitë;

c. Nëse në këtë fazë Mbrojtja mund të konfirmojë, në përputhje me rregullën 119 të Rregullores, nëse ka ndërmend të paraqesë prova, dhe, nëse po, numrin e dëshmitarëve që synon të thërrasë,[7] kohën që kërkon për marrjen e tyre në pyetje, dhe a ka ndërmend të thërrasë dëshmitarë ekspertë, pa cenuar ndryshimet e mëtejshme që do të komunikohen në kohë të mjaftueshme para paraqitjes së provave nga Mbrojtja;

d. Nëse Mbrojtja ka ndërmend të kërkojë pranimin e deklaratave apo transkripteve të dëshmive të mëparshme në vend të dëshmive gojore sipas rregullave 153-155 të Rregullores dhe, nëse po, në lidhje me cilët dëshmitarë, sa prova materiale dhe sipas cilës dispozitë; dhe

e. Nëse në këtë fazë dhe në varësi të rregullës 114(5) të Rregullores, mbrojtësja e viktimave mund ta informojë Trupin Gjykues nëse ka ndërmend të paraqesë prova dhe të thërrasë dëshmitarë (ekspertë) dhe/ose viktima pjesëmarrëse që të dëshmojnë, përkatësisht të shprehin pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre, pa cenuar ndryshimet e mëtejshme që do të komunikohen në kohë të mjaftueshme para paraqitjes së provave nga mbrojtësja e viktimave.

[7] Lista e dëshmitarëve të Mbrojtjes, f. 2.

PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

5. Radha e paraqitjes dhe çështje të lidhura me marrjen në pyetje të dëshmitarëve

a. Parashtrime nga ZPS-ja në lidhje me radhën në të cilën synon t'i thërrasë dëshmitarët e përfshirë në listën e dëshmitarëve të ZPS-së dhe nëse kjo listë është përfundimtare, si edhe modalitetet e dhënies së dëshmisë (drejtpërdrejtë ose përmes videolidhjes);

b. Nëse në këtë fazë Mbrojtja mund të bëjë të ditur se në çfarë radhe synon t'i thërrasë dëshmitarët e përfshirë në listën e dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe nëse kjo listë është përfundimtare, si edhe modalitetet e dhënies së dëshmisë (drejtpërdrejtë ose përmes videolidhjes), pa cenuar ndryshimet e mëtejshme që do të komunikohen në kohë të mjaftueshme para paraqitjes së provave nga Mbrojtja;

c. Nëse në këtë fazë dhe në varësi të rregullës 114(5) të Rregullores, mbrojtësja e viktimave mund të bëjë të ditur se në çfarë radhe synon të thërrasë dëshmitarë (ekspertë) dhe/ose viktima pjesëmarrëse për të dëshmuar ose shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre, si edhe modalitetet e dhënies së dëshmisë/paraqitjes së pikëpamjeve dhe shqetësimeve (drejtpërdrejtë ose përmes videolidhjes), pa cenuar ndryshimet e mëtejshme që do të komunikohen në kohë të mjaftueshme para paraqitjes së provave nga mbrojtësja e viktimave; dhe

d. Parashtrime në lidhje me çfarëdo çështje që palët dhe mbrojtësja e viktimave e konsiderojnë të rëndësishme në lidhje me fushëveprimin dhe mënyrën e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, duke përfshirë: (i) fillimin e marrjes në pyetje të çdo dëshmitari me përshkrim të lirë nga dëshmitari në përgjigje të pyetjeve të kryegjykatëses; (ii) përdorimin e dokumenteve apo (audio/video) materialeve të tjera gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe njoftim

PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

paraprak për këtë; dhe (iii) procedurën për informimin e Trupi Gjykues, palëve dhe mbrojtëses së viktimave para dëshmive vetinkriminuese të mundshme të dëshmitarëve.

6. Provat që nuk janë dëshmi gojore

a. Nëse ZPS-ja ose mbrojtësja e viktimave synojnë të kundërshtojnë pranueshmërinë e një prove sipas rregullës 104 të Rregullores që nuk është dëshmi gojore dhe, nëse po, cila është natyra e kundërshtimeve;

b. Nëse Mbrojta ose mbrojtësja e viktimave synojnë të kundërshtojnë pranueshmërinë e një prove sipas rregullës 102 të Rregullores që nuk është dëshmi gojore dhe, nëse po, cila është natyra e kundërshtimeve; dhe

c. Parashtrime nga palët dhe mbrojtësja e viktimave nëse vendimi për pranueshmërinë e një prove që nuk është dëshmi gojore duhet të jepet kur prova në fjalë paraqitet si provë materiale gjatë vetë gjykimit, apo të lihet për në aktgjykim, pasi palëve dhe mbrojtëses së viktimave t'u jetë dhënë mundësia për të bërë parashtrime, nëse dëshirojnë, në lidhje me pranueshmërinë e një prove të tillë.

7. Konstatim gjyqësor i fakteve të shqyrtuara në procese të tjera

a. Nëse Mbrojtja dhe ZPS-ja e kanë diskutuar mundësinë për t'i kërkuar Trupit Gjykues të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera sipas rregullës 157(2) të Rregullores;

b. Nëse ZPS-ja synon t'i kërkojë Trupit Gjykues të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera brenda kuptimit të rregullës 157(2) të

PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

Rregullores dhe, nëse po, kur synon të bëjë një kërkesë të tillë dhe në lidhje me sa fakte; dhe

c. Nëse në këtë fazë Mbrojtja parashikon t'i kërkojë Trupit Gjykues të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera brenda kuptimit të rregullës 157(2) të Rregullores dhe, nëse po, kur synon të bëjë një kërkesë të tillë dhe në lidhje me sa fakte.

11. Përveç pikave të përmendura më lart, Trupi Gjykues e konsideron të përshtatshme mbajtjen e një seance të mbyllur, *ex parte*, me ZPS-në, ZMMD-në dhe përfaqësuesin e Zyrës Administrative, për të diskutuar disa aspekte të caktuara në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, si dhe aspektet praktike të dhënies së dëshmisë prej dëshmitarëve që do të thirren, që janë thelbësore për vendimin e Trupit Gjykues në lidhje me zhvillimin e procesit gjyqësor dhe, më përgjithësisht, për caktimin e orarit të seancave gjyqësore. Kjo seancë do të mbahet pasi të jenë shterur diskutimet me Mbrojtjen dhe mbrojtësen e viktimave dhe do të kufizohet në pikat e renditura në shtojcën 1 të vendimit aktual, pa cenuar të drejtën e Trupit Gjykues për të bërë çfarëdo pyetje tjetër që e konsideron të nevojshme.

12. Gjithashtu, pas përfundimit të seancës me ZPS-në dhe ZMMD-në/Zyrën Administrative, Trupi Gjykues e konsideron të arsyeshme që më tej të mbajë një seancë të mbyllur, *ex parte*, në praninë vetëm të ZPS-së, për të diskutuar disa çështje hetimore të caktuara, sikurse renditen në shtojcën 2 të vendimit aktual, pa cenuar të drejtën e Trupit Gjykues për të bërë çfarëdo pyetje tjetër që e konsideron të nevojshme.

13. Në fund, Trupi Gjykues e konsideron të përshtatshme të marrë parashtrime nga palët dhe mbrojtësja e viktimave për atë nëse duhet të trajtohen edhe pika të tjera krahas atyre të përmendura më lart në këtë vendim dhe nëse duhet të organizohen konferenca të tjera për ecurinë e çështjes para fillimit të gjykimit dhe, nëse po, kur dhe për cilat pika.

PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

14. Palët dhe mbrojtësja e viktimave duhet t'i dorëzojnë parashtrimet e tyre me shkrim në lidhje me cilëndo nga pikat e mësipërme, ose çfarëdo pike tjetër në këtë kontekst që nuk është mbuluar në vendimin aktual dhe shtojcat e tij, më së voni deri të mërkurën, 2 qershor 2021. Brenda të njëjtit afat, ZPS-ja gjithashtu duhet të paraqesë parashtrime me shkrim për pikat e renditura në shtojcat 1-2 të këtij vendimi; dhe ZMMD-ja/Zyra Administrative duhet të paraqesin parashtrime me shkrim në lidhje me procesin e përgatitjes së dëshmitarëve për dhënien e dëshmive, si dhe në lidhje me pikat e përfshira në shtojcën 1 të këtij vendimi, në mënyrë që Trupi Gjykues të sigurojë informacion të plotë dhe të hollësishëm për të nxjerrë vendimin e ardhshëm mbi zhvillimin e procesit gjyqësor.

15. Trupi Gjykues rikujton se, në përputhje me nenin 40(6)(a) të Ligjit, Trupi Gjykues mund të ushtrojë të gjitha funksionet ose kompetencat e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të përcaktuara në nenin 39 të Ligjit, si edhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e shpejtë të gjykimit, siç është mbajtja e konferencave për ecurinë e çështjes me modalitetet e pjesëmarrjes të përcaktuara në rregullën 96 të Rregullores.

16. Rrjedhimisht, megjithëse z. Mustafa dhe Mbrojtësi i tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm fizikisht, në përputhje me rregullën 96(2) të Rregullores dhe duke pasur parasysh natyrën teknike të pikave që do të diskutohen, konferenca për ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e Mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e Mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit, me praninë e Mbrojtësit, ose pjesëmarrjen e Mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës. Gjithsesi, për këto masa nevojitet dhënia e pëlqimit me shkrim nga i akuzuari, pas këshillimit me Mbrojtësin e vet, në pajtim me rregullën 96(2) të Rregullores, dhe në pajtim me praktikën e miratuar gjatë fazës së procedurës paraprake.

PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

IV. VENDIM

17. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

a. **VENDOS** që të mbajë konferencë përgatitore për gjykimin, në seancë publike, në praninë e ZPS-së, Mbrojtjes dhe mbrojtëses së viktimave, **të mërkurën, më 9 qershor 2021, në orën 09:30**, e cila do të vazhdojë, nëse është e nevojshme, **të enjten, më 10 qershor 2021, në orën 09:30**;

b. **VENDOS** të mbajë konferencë përgatitore për gjykimin, *ex parte* dhe në seancë të mbyllur, në praninë e ZPS-së, ZMMD-së dhe përfaqësuesit të Zyrës Administrative, **të enjten, më 10 qershor 2021, në orën 14:30**, ose menjëherë pas përfundimit të seancës së mëparshme, e cila do të vazhdojë, nëse është e nevojshme, **të premten, më 11 qershor 2021, në orën 09:30**;

c. **VENDOS** të mbajë konferencë përgatitore për gjykimin, *ex parte* dhe në seancë të mbyllur, në praninë e ZPS-së, **të premten, më 11 qershor 2021, në orën 11:30** ose menjëherë pas përfundimit të seancës së mëparshme; dhe

d. **KËRKON** nga ZPS-ja, Mbrojtja, mbrojtësja e viktimave dhe ZMMD-ja/Zyra Administrative që të paraqesin parashtrimet e tyre me shkrim në përputhje me paragrafin 14 të këtij vendimi.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

PUBLIC
Date original: 20/05/2021 17:02:00
Date translation: 22/07/2021 09:12:00

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 20 maj 2021
Në Hagë, Holandë.